

RELACION PERSHKRIMOR

OBJEKTI

“REHABILITIM I PJESHEM I GODINES DHE OBORRIT TE NJESISE ADMINISTRATIVE RUZHDIE”





Foto te gjendjes ekzistuese te godines

1. Gjendja aktuale

Godina aktuale e njesise administrative Ruzhdie ndodhet ne gjendje jo te pershtatshme sa i takon kushteve te brendeshme dhe ambienteve perreth. Kemi problematika si ne pjesen brenda ashtu dhe jashte te godines. Prej shume kohesh nuk jane bere nderhyrje ne kete godine duke bere ne kete menyre ate problematike per ofrimin e sherbimeve, per qendrimin e punonjeseve dhe banoreve te zones qe drejtohen per marrjen e sherbimeve ne ate godine. Ne keto kushte nderhyrjet ne godine jane te domosdoshme te realizohen sipas standarteve te projektimit.

2. Përshkrim i Projektit

Projekti parashikon nderhyrjen e pjesshme ne te gjithe godinen dhe sheshin perreth. Nderhyrjet kryesore ne projekt kane perfshire tarracen me shtresat perkatese te saj, fasadat e godines, rifiniturat, rrjetin e kanalizimeve, punime elektrike dhe hidraulike si dhe sheshin perreth. Hidroizolimi i tarraces do te riparohet dhe realizohet i ri ne ato pjese ku eshte demtuar. Gjithashtu do te realizohet fasade me polisterol xps $t=2\text{cm}$, dhe do vendosen dritare duralumin dopio xham. Nderhyrje jane parashikuar dhe ne sistemin elektrik, hidraulik dhe sistemin e mbrojtjes nga shkarkesat atmosferike. Sipas standarteve te projektimit eshte parashikuar dhe montimi i kamerave te survejimit dhe impanteve antizjarr. Sheshi perreth godines do te pastrohet dhe sistemohet sic eshte parashikuar ne projekt do te realizohet shtrim me pllaka dekorative trotuari dhe mbjelle bari ne zonat e caktuara. Stola per qendrimin e banoreve dhe ndricimi i nevojshem eshte parashikuar sipas standarteve.



Foto 3D te godines

